

NJOFTIM
I MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME

Nr. 6088, datë 5.5.2017

1. Marrëveshje mbi ndryshimet e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë dhe Hercegovinës mbi lëvizjen e ndërsjellë të qytetarëve, nënshkruar më 30.7.2015, hyrë në fuqi më 17.3.2017.

2. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin në fushën e sigurisë, nënshkruar më 31.5.2013, hyrë në fuqi më 23.2.2017.

3. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mongolisë për përjashtimin nga kërkesa për vizë të mbajtësve të pasaportave biometrike diplomatike, shërbimit dhe zyrtare, nënshkruar në Gjenevë, më 28.2.2017, hyrë në fuqi më 29.3.2017.

4. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi Bashkëpunimin Financiar 2016 për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni”, nënshkruar më 26.7.2016, hyrë në fuqi më 9.3.2017.

5. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi Bashkëpunimin Financiar 2016 për projektin “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni (zgjerim)”, nënshkruar më 28.10.2016, hyrë në fuqi më 9.3.2017.

6. Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Drejtësisë së BE-së, nënshkruar në Bruksel, më 28.9.2016, hyrë në fuqi në datën 1.1.2017.

7. Marrëveshja Istisna’a (Financim shtesë) dhe Marrëveshja e Agjencisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim “Për rrugën Tiranë-Elbasan”, nënshkruar dhe hyrë në fuqi më 26.1.2017.

8. Marrëveshje e angazhimit për zhvillimin e tregut të gazit dhe marrëveshja për përfitimet vendase, të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë, e cila vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellsit Trans Adriatik, nënshkruar më 1.3.2017, hyrë në fuqi më 29.3.2017

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Gazmend Barbullushi